

THE ALBANIAN LANGUAGE AND CULTURAL HERITAGE THROUGH THE SCHOLARLY WORK OF PROF. DR. SIMON PEPA

GJUHA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE SHQIPTARE PËRMES VEPRËS SË PROF. DR. SIMON PEPËS

Rezearta MURATI¹

^{1*} *Department of Language, Faculty of Social Sciences, University of Shkodra „Luigji Gurakuqi“*

**Corresponding author e-mail: rezearta.murati@unishk.edu.al*

Abstract

Prof. Dr. Simon Pepa (1936–2002) stands as one of the most prominent and influential scholars in the field of Albanian linguistics, with significant contributions to the enrichment and advancement of Albanological studies. His academic work spans across key areas such as lexicology, dialectology, phonetics, and ethnolinguistics. Through his research, he significantly expanded the understanding of the structure and development of the Albanian language, while also contributing to the documentation of Albania's cultural and historical heritage. Among his most notable works is the monograph “Agricultural Tradition through the Linguistic Treasury”, which offers a profound analysis of the use of the Albanian language in rural and agricultural life.

This study enriches the Albanian lexicon with important elements of cultural heritage, shedding light on the linguistic representation of traditional practices. In addition, Prof. Pepa made substantial contributions to the study of euphemisms and taboos—an area that has provided valuable insights into how Albanians use language to address socially sensitive and complex topics. His research in this domain has deepened the understanding of the cultural mechanisms underlying linguistic expression. His international engagement, marked by participation in conferences and scholarly symposia, further promoted the visibility of the Albanian language and culture on the global academic stage.

This involvement has played a vital role in the development of Albanology and the establishment of international networks for scientific collaboration. This paper seeks to highlight the impact and enduring significance of Prof. Dr. Simon Pepa's scholarly work, underlining his contributions to the study of the Albanian language and cultural heritage. His legacy continues to enrich linguistic knowledge and supports the advancement of future research in the field of Albanology.

Keywords: *Prof. Dr. Simon Pepa, Albanian language, cultural heritage, taboo and euphemism, lexicology, dialectology.*

Përmbledhje

Prof.dr. Simon Pepa (1936-2002) është një nga studiuesit e njohur dhe të rëndësishëm të gjuhësisë shqiptare, me kontribut në pasurimin dhe zhvillimin e albanologjisë. Ai ka dhënë ndihmesën e tij në fushat e leksikologjisë, dialektologjisë, fonetikës dhe etnolinguistikës. Vepra e tij ka pasuruar njohuritë mbi strukturën dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, duke ndihmuar në dokumentimin e trashëgimisë kulturore dhe historike shqiptare.

Një nga studimet më të rëndësishme të tij është monografia “Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor”, e cila ofron një analizë të thellë të përdorimit të gjuhës shqipe në jetën bujqësore, duke pasuruar leksikun e gjuhës me elemente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare. Përveç kësaj, Pepa ka sjellë kontribut të rëndësishëm në fushën e studimit të eufemizmave dhe tabuve, një shqyrtim që ka ndihmuar në kuptimin e mënyrës sesi shqiptarët përdorin gjuhën për të trajtuar tema të ndjeshme dhe të vështira shoqërore. Angazhimi i tij

ndërkombëtar ka ndihmuar në njohjen dhe promovimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare, përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe simpoziume shkencore.

Kjo ka kontribuar në zhvillimin e albanologjisë dhe në krijimin e lidhjeve ndërkombëtare për kërkime shkencore. Ky punim synon të prezantojë ndikimin dhe rëndësinë e veprës shkencore të Prof. dr. Simon Pepës, duke theksuar kontributet e tij në fushën e gjuhësisë shqiptare dhe trashëgimisë kulturore, të cilat kanë pasuruar njohuritë për gjuhën shqipe dhe kanë mbështetur zhvillimin e kërkimeve të ardhshme në këtë fushë.

Fjalët kyçe: Prof.dr. Simon Pepa, gjuha shqipe, trashëgimia kulturore, tabu dhe eufemizma, leksikologjia dhe dialektologjia.

Hyrje

Prof.dr. Simon Pepa është një nga figurat e njohura dhe të respektuara të gjuhësisë shqiptare, me kontribut në studimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Ai ka qenë një akademik dhe pedagog i palodhur, që ka lënë një ndikim të madh në fushat e leksikologjisë, dialektologjisë, fonetikës dhe në ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore të Shqipërisë. Rugëtimi i tij shkencor dhe pedagogjik ka qenë një udhërrëfyes për shumë breza studiuesish dhe pedagogësh dhe veprat e tij janë të pranishme si referenca për të kuptuar më thellë strukturën, zhvillimin dhe pasuritë e gjuhës shqipe.

Pepa ka lindur në Shkodër, në vitin 1936 dhe ka kryer studimet në një kohë kur Shqipëria po kalonte një periudhë të rëndësishme transformimi social dhe kulturor. Pas mbarimit të studimeve dhe periudhës së punës si mësues në shkollat e fshatrave të Shkodrës, u angazhua si pedagog dhe kërkues shkencor. Ai ishte një nga themeluesit e Sektorit të Albanologjisë në Universitetin e Shkodrës, i cili luajti një rol kyç në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare, duke e çuar këtë fushë në nivele të reja kërkimore dhe akademike.

Një nga arritjet më të rëndësishme të prof. Pepës është ndihmesa e tij në studimin dhe pasurimin e leksikologjisë shqiptare. Ai ka studiuar dhe dokumentuar leksikun e përdorur në trevat veriore të Shqipërisë, duke kontribuar në kuptimin e pasurisë leksikore dhe evoluimin e gjuhës shqipe. Vepra e tij më e rëndësishme në këtë fushë është monografia "*Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*", e cila përmban një analizë të detajuar të fjalorit bujqësor të trevave veriore, si dhe një fjalor të pasur që dokumenton përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve të përdorura në jetën bujqësore. Ky studim është një shembull i shkëlqyer i metodës shkencore të prof. Pepës, duke përdorur burime historike dhe gojore për të ndriçuar aspektet më të rëndësishme të traditës kulturore dhe gjuhësore shqiptare.

Simon Pepa ka qenë gjithashtu një nga pionierët në studimin e eufemizmave dhe tabuve në gjuhën shqipe, një fushë që kishte mbetur relativisht e papërpunuar deri në ato vite. Monografia "*Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*" është një analizë thelbësore e këtij fenomeni gjuhësor dhe kulturore, e cila sjell një kontribut të rëndësishëm në kuptimin e fenomeneve që lidhen me normat shoqërore dhe gjuhësore të shprehura në gjuhën shqipe.

Në aspektin ndërkombëtar, prof. Pepa ka pasur një angazhim të madh në konferenca shkencore dhe simpoziume, duke ndarë njohuritë e tij me studiues të huaj dhe duke promovuar gjuhën dhe kulturën shqiptare në arenën ndërkombëtare. Ai ka marrë pjesë në ngjarje të rëndësishme shkencore dhe akademike, si dhe ka ndihmuar në krijimin e lidhjeve ndërkombëtare që ndihmuan në zhvillimin e albanologjisë dhe studimeve gjuhësore shqiptare. Ky punim do të shqyrtojë në mënyrë më shteruese kontributet e prof. Simon Pepës, duke analizuar veprat e tij kryesore dhe ndikimin që ka pasur në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare.

Rëndësia e tij nuk qëndron vetëm në aspektin shkencor, por edhe në pasionin dhe dedikimin për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare. Përmes punës së tij, ai ka bërë të mundur që shumë aspekte të gjuhës dhe kulturës shqiptare të dokumentohen dhe të mbeten të ruajtura për brezat që do të vijnë.

Jeta dhe veprimtaria akademike

Prof. dr. Simon Pepa u emërua pedagog pranë Universitetit të Shkodrës në shtator të vitit 1973, pas një përvoje të gjatë dhe të pasur si mësues në shkollat e fshatrave të Shkodrës, ku kishte shërbyer me përkushtim për 19 vite. Ky tranzicion nga arsimi parauniversitar në arsimin e lartë shënoi një etapë të re në jetën e tij akademike dhe kërkimore. Gjatë gati tre dekadave të aktivitetit të tij në universitet, ai ishte titullar i lëndëve themelore në fushën e gjuhësisë shqiptare, si *Leksikologjia* dhe *Fonetikë-Fonologjia*, të cilat i zhvilloi me rigorozitet shkencor dhe pasion pedagogjik deri në fund të jetës. Ndikimi i tij në formimin profesional të brezave të studentëve ishte i thellë, ndërsa qasja e tij në trajtimin e fenomeneve gjuhësore bazohej në një ndërthurje të metodologjisë klasike me qasje bashkëkohore analitike.

Në vitin 1995, me themelimin e Sektorit të Albanologjisë, në kuadër të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, prof. Pepa u caktua punonjës shkencor pranë tij. Në bashkëpunim me prof. Tomor Osmanin, ai kontribuoi në strukturimin institucional dhe profilin kërkimor të këtij sektori, duke e kthyer atë në një pol të rëndësishëm të kërkimit shkencor në fushën e gjuhësisë dhe kulturës shqiptare. Ai ishte pjesë aktive e redaksive dhe një nga redaktorët e botimeve albanologjike, ndër të cilat veçohen monografia *Leksiku historik i gjuhës shqipe* e prof. dr. Kolë Ashtës dhe kolana *Studime shqiptare*. Gjithashtu, ai shërbeu si recensent për veprat me rëndësi madhore, si *Fjalori arbërisht-shqip* i prof. Kolë Kamsit. Kontributi i tij mbetet një pikë referimi për studimet albanologjike bashkëkohore (Osmani, 2017).

Ai është një nga figurat përfaqësuese të gjuhësisë shqiptare, me një kontribut të qëndrueshëm dhe të gjithanshëm në fushën e kërkimit shkencor, leksikografisë, mësimdhënies universitare dhe kulturës shkencore në përgjithësi. Veprimtaria e tij shkencore është e shtrirë në më shumë se katër dekada dhe është konkretizuar në botime, kumtesa, bashkëpunime ndërkombëtare dhe tekste mësimore që kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare dhe në formimin akademik të brezave të rinj studiuesish.

Prof. Pepa ka shkruar dhe botuar dhjetëra artikuj dhe studime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, ku ka trajtuar tema të ndryshme të leksikologjisë, dialektologjisë, semantikës etj. Artikujt e tij dallohen për qasjen analitike, për vëmendjen ndaj të dhënave konkrete nga e folmja popullore dhe për përpjekjen e vazhdueshme për të ruajtur dhe interpretuar trashëgiminë leksikore të shqipes. Ka marrë pjesë në konferenca dhe simpoziume të shumta brenda dhe jashtë vendit, ku ka kumtuar tema të rëndësishme në qendra akademike me peshë, si Zagrebi dhe Nju-Jorku. Po ashtu, ka qenë i ftuar për bashkëpunim akademik nga institucione të njohura si Universiteti i Padovës dhe ai i Barit në Itali, ku ka shkëmbyer përvoja në fushën e gjuhësisë krahasimtare dhe të leksikografisë.

Një pjesë e mirë e këtyre punimeve u përmbledhën në vitin 2000 në veprën “*Gjurmime kulturore*”, ku autori evidenton ndërlidhjen midis gjuhës dhe kulturës dhe i jep trajtim të thelluar disa dukurive të shqipes në përdorimin e saj të gjallë. Përveç punës së tij individuale, prof. Pepa ka qenë edhe bashkautor në katër tekste universitare, të cilat kanë shërbyer si bazë për mësimdhënien e lëndëve gjuhësore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Shkodrës.

Fushat e studimit dhe veprat kryesore

1. *Studimi i leksikut bujqësor në trevat veriore të Shqipërisë* : Fusha qendrore e kërkimeve të tij ka qenë studimi i leksikut bujqësor në trevat veriore të Shqipërisë. Ky interes i veçantë dhe afatgjatë u kurozëzua me botimin e monografisë “*Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*” në vitin 2002, e cila përbëhet nga dy vëllime. Në vëllimin e parë, autori trajton aspektin teorik të leksikut bujqësor: ai shqyrton strukturën semantike të këtij leksiku, lidhjet kuptimore ndërmjet fjalëve, ngjyrimin emocional dhe stilistik të tyre, si dhe tiparet fonetike,

morfologjike dhe fjalëformuese që karakterizojnë të folmen dialektore të zonave rurale veriore. Vëmendje e veçantë i kushtohet polisemisë, sinonimisë dhe formimit të njësive frazeologjike, duke u përpjekur të nxjerrë në pah dinamizmin e fjalësisë tradicionale në raport me kontekstin shoqëror dhe kulturor (Osmani, 2017).

Vëllimi i dytë përmban një fjalor të strukturuar sipas standardeve bashkëkohore leksikografike, ku çdo njësi leksikore është trajtuar me përpikëri shkencore. Çdo fjalë paraqitet me formën dialektore përkatëse, me të gjitha variantet fonetike dhe gramatikore, shpjegimin e kuptimeve, përdorimin frazeologjik, si dhe ilustrime konkrete të marra nga e folmja autentike e zonës. Ky fjalor nuk është vetëm një përpjekje për të ruajtur pasurinë leksikore bujqësore, por edhe një dëshmi e gjallë e mënyrës së jetesës tradicionale dhe e lidhjes së ngushtë midis gjuhës dhe jetës së përditshme.

Vepra në tërësinë e saj është një burim referimi për studiuesit e leksikologjisë, etnolingusitikës dhe dialektologjisë shqiptare. Ajo përmban vlera të mëdha dokumentuese, por edhe praktike, pasi mund të shërbejë si model për fjalorë të tjerë tematikë. Përkushtimi i studiuesit Pepa në dokumentimin dhe analizën e kësaj trashëgimie gjuhësore tregon jo vetëm për nivelin e tij të lartë profesional, por edhe për një ndjeshmëri të thellë kulturore ndaj pasurisë shpirtërore të popullit shqiptar. Në këtë kontekst, kontributi i tij i kalon kufijtë e një studimi individual dhe shndërrohet në një akt me rëndësi për ruajtjen e identitetit dhe të gjuhës shqipe.

2. *Studimi i tabuve dhe eufemizmeve në gjuhën shqipe*: Një tjetër temë me rëndësi të veçantë në veprimtarinë kërkimore të Simon Pepës ka qenë studimi i tabuve dhe eufemizmeve në gjuhën shqipe, një fushë relativisht e paeksploruar më herët në mënyrë sistematike në studimet albanologjike. Vëmendja që i ka kushtuar kësaj fushe vjen si rezultat i një përkushtimi të vazhdueshëm për të ndriçuar aspekte të ndryshme të ligjërimit popullor dhe të pasurisë shprehëse të shqipes, të lidhura ngushtë me strukturën kulturore dhe psikologjike të shoqërisë shqiptare.

Pas një sërë artikujsh dhe punimesh të botuara në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, ku është trajtuar kjo tematikë në aspekte të ndryshme, në vitin 2000, Simon Pepa, në bashkëpunim me studiuesin Tomor Osmani, boton monografinë me titull “*Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*”. Ky botim përfaqëson një ndër përpjekjet e para serioze për të trajtuar këtë fushë në mënyrë të organizuar, në një këndvështrim ndërdisiplinor dhe me baza të qarta shkencore.

Monografia është konceptuar në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë ka karakter teorik dhe shqyrton konceptin e tabusë dhe eufemizmit nga një këndvështrim etno-gjuhësor, duke i vendosur këto dukuri në kontekstin më të gjerë të marrëdhënies mes gjuhës, mendësisë tradicionale dhe realitetit social. Autorët shmangin vendosjen e kufijve të ngurtë ndërmjet nocioneve tabu dhe eufemizëm, duke theksuar ndërthurjen e tyre funksionale në praktikën gjuhësore të përditshme. Në këtë pjesë trajtohen gjithashtu funksionet shoqërore të eufemizmit, si formë zbutjeje e të shprehurit, mekanizmat psikologjikë që e gjenerojnë dhe qëllimet pragmatike që synon përdorimi i tij. “Shqiptarët e kanë përdorur gjuhën si mjet për të ruajtur normat morale dhe për të menaxhuar çështje që shoqëria i konsideronte të papërshtatshme për t’u shqiptuar drejtpërdrejt” (Pepa, Osmani, 2000).

Pjesa e dytë e monografisë përbëhet nga një fjalorth eufemizmesh, i cili dokumenton dhe klasifikon një numër të konsiderueshëm eufemizmesh të përdorura në gjuhën shqipe. Eufemizmat janë përzgjedhur duke pasur parasysh tematika të ndryshme tabu në kulturën shqiptare, si p.sh.: sfera e seksualitetit, sëmundjet, vdekja, funksionet trupore, besimet popullore, si dhe elementë që lidhen me fatin, mëkatën apo marrëdhëniet familjare dhe shoqërore. Fjalori paraqet jo vetëm fjalët e zëvendësuara dhe ato zëvendësuese, por edhe një analizë të shkurtër semantike dhe pragmatike të tyre.

Në monografi trajtohen aspekte të rëndësishme të strukturave gjuhësore të eufemizmeve; mjetet gjuhësore për zbutjen e shprehjes, si: metafora, metonimia, sinonimia, lakonizmi, perifraza; si dhe rastet e polisemisë në funksion eufemizues. Gjithashtu, jepet një panoramë e shkurtër mbi përdorimin e eufemizmeve dhe tabuve në folklor dhe në letërsinë artistike shqipe, si forma të reflektimit të vetëdijes kolektive për të zbutur të pathënat, të ndjeshmet dhe të frikshmet në mënyrën e të shprehurit. “Tabutë gjuhësore janë një pasqyrë e drejtpërdrejtë e ndërgjegjes kulturore të një shoqërie” (Pepa, Osmani, 2000).

Vlerat e kësaj monografie janë të shumëfishta.

- Së pari, paraqet një dëshmi të rëndësishme të lidhjes së ngushtë midis gjuhës dhe mendësisë popullore shqiptare, duke treguar se gjuha nuk është vetëm mjet komunikimi, por edhe një sistem i pasur ku pasqyrohet thellësisht përvoja, morali dhe ndërgjegjja kolektive.

- Së dyti, kontribuon në krijimin e një baze terminologjike dhe konceptuale për kërkime të mëtejshme, duke hapur rrugën për analiza të reja në gjuhësi, sociolinguistikë, etnolinguistikë dhe studime kulturore.

Puna kërkimore dhe përpunimi teorik i bërë nga Simon Pepa dhe bashkëpunëtori i tij Tomor Osmani në këtë vepër përbëjnë një model serioz metodologjik dhe përfaqësojnë një qasje origjinale në leksikografinë tematike shqipe. Në këtë kuptim, monografia “*Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*” mbetet një referencë e rëndësishme për studiuesit e gjuhës shqipe dhe për çdo kërkues që interesohet për marrëdhënien mes gjuhës dhe kulturës në shoqërinë shqiptare.

3. *Vlerësimi i figurave të shquara të klerit katolik shqiptar*: Në fushën e kërkimeve të tij të gjera shkencore, një vend të veçantë zë angazhimi i prof. dr. Simon Pepës për evidentimin dhe vlerësimin e figurave të shquara të klerit katolik shqiptar, të cilët kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën shpirtërore, kulturore dhe gjuhësore të vendit. Ky dimension i veprimtarisë së tij nuk përfaqëson vetëm një aspekt biografik të studimit, por është një qasje shumëplanëshe që shtrihet nga analiza historike, gjuhësore dhe letrare, deri te përsiatjet personale dhe etike që i japin trajtesave një karakter të thellë human e dokumentar.

Ndër figurat që kanë zënë vend qendror në punën e tij përmenden: Atë Justin Rrota, Atë Fulvio Kordinjano, Atë Daniel Dajani, Atë Giovanni Fausti, Atë Gjergj Fishta dhe të tjerë, përmes të cilëve Pepa përpiqet të rindërtojë një profil kolektiv të dijetarit katolik shqiptar, që përtej thirrjes fetare, shfaqet, si: intelektual, edukator, mbrojtës i identitetit kombëtar dhe kontribuues në gjuhësi, arsim dhe kulturë (Osmani, 2017). Një nga veprat themelore që dëshmon për këtë përkushtim është libri “*Daniel Dajani S.J., Giovanni Fausti S.J. – Dëshmitarë të një feje që nuk vdes*” (1995), i botuar në bashkëpunim me studiues të tjerë.

Në këtë vepër, Simon Pepa ndërton një narrativë historike të pasur dhe të argumentuar mbi jetën dhe veprimtarinë e dy prej figurave më të ndritura të Urdhrit të Jezuitëve në Shqipëri, duke i paraqitur jo vetëm si viktime të një regjimi represiv, por edhe si dëshmitarë të guximshëm të dijes dhe besimit (Kapinova, 2007). Veçanërisht i thelluar është trajtimi i figurës së Atë Daniel Dajanit, i cili përveç se ishte një edukator dhe udhëheqës shpirtëror, dha një kontribut të shquar në fushën e publicistikës dhe të formimit kulturor të rinisë përmes drejtimit të revistës “*Lajmëtari i Zembrës së Krishtit*” (Pepa, 1995). Kontributi i prof. Pepës nuk ndalet vetëm në analizën e jetës dhe veprës së këtyre figurave, por shtrihet edhe në një dimension emocional dhe përjetues, që vjen në formë kujtimesh autentike.

Kështu, në artikullin “*Justin Rrota – personalitet i kulturës dhe i letrave shqipe*”, ai ndërton një portret të plotë të këtij dijetari, duke evidentuar veprat e tij gjuhësore dhe kulturore, por edhe duke ndarë me lexuesin kujtime të çmuara: “...Më kujtohet si tani që pas viteve ’60... tek dhoma e Pater Justinut mund të shkoje vetëm tinëz, natën...” (Pepa, 1995). Këto kujtime i japin trajtesës një vlerë të shtuar dokumentare dhe emocionale, duke e kthyer tekstin në një urë lidhëse ndërmjet brezave. Në rastin e Atë Fulvio Kordinjanos, vlerësimi fokusohet në kontributin e tij të vyer në gjurmimin e pasurisë leksikore të shqipes, që u konkretizua në hartimin e dy fjalorëve të rëndësishëm, të ndërtuar mbi një bazë solide etnografike dhe

dialektore. Pepa e paraqet Kordinjanon jo vetëm si një gjuhëtar të përkushtuar, por edhe si një figurë që vuajti moralisht për gabimet që, sipas tij, kishte bërë nën trysninë e kohës (Pepa, 2000).

Ky trajtim i balancuar midis arritjes shkencore dhe ndjeshmërisë personale është karakteristikë e mënyrës se si autori ndërton portretet e tij. Një tjetër figurë madhore e trajtuar është Atë Gjergj Fishta, për të cilin Pepa ka realizuar analiza gjuhësore të hollësishme, si në punimin “*Veçori gjuhësore në veprën poetike të At Gjergj Fishtës*”. Në këtë trajtesë, ai vëren se “*Me veprën e Fishtës populli kaloi gëzime e halle, pse Fishta e populli qenë një*”, duke vënë theksin te gjuha si reflektim i shpirtit të një kombi dhe Fishta si përfaqësuesi më i denjë i këtij identiteti gjuhësor dhe kombëtar (Pepa, 1995).

Këtë përkushtim afatgjatë për figurat e klerit dhe për krahinat që i lindën ato, prof. Pepa e përmbledh në veprën “*Zadrima dhe bijtë e ndritur të saj*” (2003), e botuar pas ndarjes së tij nga jeta, me përkujdesjen e bashkëshortes dhe fëmijëve. Vepra është e ndarë në tetë kapituj, ku trajtohet: historia e krahinës së Zadrimës, roli i saj në historinë e katolicizmit shqiptar, dhe kontributi i bijve të saj në arsim, kulturë dhe fe. Një vend të veçantë zë martirizimi i klerit të kësaj zone, ndërsa kapitujt e fundit ofrojnë kujtime personale dhe jehonën ndërkombëtare, sidomos në shtypin italian. Në tërësi, këto shqyrtime të prof. dr. Simon Pepës përfaqësojnë jo vetëm një kontribut të çmuar për albanologjinë, por edhe një përpjekje fisnike për të ruajtur kujtesën kulturore dhe shpirtërore të një kombi, përmes portretizimit të figurave që përfaqësojnë ndërgjegjen kombëtare dhe morale të tij.

4. *Shqyrtimi i vlerave gjuhësore të veprat të autorëve të letërsisë shqipe*: Një aspekt thelbësor dhe i dallueshëm i veprimtarisë shkencore të studiuesit është padyshim shqyrtimi dhe evidentimi i vlerave gjuhësore, veçanërisht në planin leksikor, në veprat e autorëve të letërsisë shqipe. Kjo qasje analitike nuk kishte si synim vetëm komentimin stilistik të gjuhës letrare, por synonte të nxirrte në pah pasurinë e gjuhës shqipe, funksionet shprehëse të saj, si dhe potencialin krijues të autorëve nëpërmjet përdorimit të leksikut popullor, dialektor dhe atij të trajtësuar nga përvoja personale.

Në këtë kontekst, prof. Pepa ka trajtuar me thellësi dhe vëmendje veprën poetike të Arshi Pipës, një nga figurat më komplekse të letërsisë shqiptare të shekullit XX. Ai vëren se gjuha në poezinë e Pipës është thellësisht e mbështetur në leksikun popullor, por nuk ndalet vetëm në përdorimin e fjalëve të trashëguara nga e folmja popullore. Ai thekson se autori, përmes një intuete krijuese të veçantë, jo vetëm që gjallëron fjalë të bukura popullore duke u dhënë atyre një dimension të ri stilistik, por edhe krijon një numër fjalësh të reja, gjithmonë duke ruajtur frymën e natyrshme të gjuhës së popullit (Pepa, 2000). Ky proces, sipas Pepës, dëshmon për një aftësi të lartë të asimilimit gjuhësor, ku tradita leksikore dhe fryma moderne ndërthuren në mënyrë organike.

Në një tjetër analizë të rëndësishme, ai ndalet te gjuha e Migjenit, poetit dhe prozatorit të mirënjohur, të cilin e cilëson si një nga përdoruesit më të fuqishëm të gjuhës shqipe në dimensionin e saj shprehës dhe emocional. Pepa vëren se gjuha migjeniane është e pasur jo vetëm në fjalë dhe shprehje, por sidomos në nuanca kuptimore dhe ndërtime frazeologjike që e bëjnë atë të dallueshme dhe të fuqishme në përçimin e dramës së individit dhe shoqërisë shqiptare të kohës.

Ai veçon gjithashtu prirjen e Migjenit për të zgjeruar kuptimet ekzistuese të fjalëve apo edhe për të krijuar njësi të reja leksikore, që sot përbëjnë pasuri të qëndrueshme të leksikut të shqipes letrare (Pepa, 2000). Ky shqyrtim i leksikut në veprat e autorëve të ndryshëm, të ndjekur me përpikëri shkencore dhe ndjeshmëri estetike, përfaqëson një nga shtyllat më të rëndësishme të kontributit të prof. Simon Pepës në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe të stilistikës. Nëpërmjet punës së tij të palodhur, ai arriti të dokumentojë dhe të analizojë funksionimin e gjuhës në kontekste konkrete letrare, duke dhënë kështu një ndihmesë të çmuar për studimet stilistike dhe semantike në shqipe.

Në thelb të këtij misioni shkencor qëndronte një dashuri e thellë për fjalën shqipe dhe një vetëdije e lartë për rolet që gjuha luan si bartëse e identitetit kombëtar, si dhe si mjet shprehjeje artistike e intelektuale. Pepa nuk e shihte fjalën thjesht si objekt studimi statik, por si një entitet të gjallë, që jeton, ndryshon dhe pasurohet nga përdorimi i autorëve, nga goja e popullit, nga historia dhe nga ndërgjegjja e kohës. Kontributi i tij në këtë fushë, përveç vlerës dokumentuese dhe gjuhësore, ka edhe një dimension pedagogjik dhe formues, pasi i ofron brezave të rinj një shembull të qasjes së kujdesshme dhe të përgjegjshme ndaj gjuhës amtare (Osmani, 2017). Ai ka dëshmuar me punën e tij se gjuhësia nuk është thjesht një disiplinë e matshme statistikisht, por një fushë e gjallë studimi që kërkon vëmendje, ndjeshmëri dhe përkushtim njerëzor.

Krijimtaria letrare

Simon Pepa, i njohur për kontributin e tij të gjerë shkencor në fushën e gjuhësisë, është shfaqur gjithashtu si një shpirt i ndjeshëm dhe i frymëzuar në krijimtarinë poetike. Herë pas here, ai i është kthyer poezisë si një formë intime shprehjeje, duke derdhur në vargje dashurinë e thellë dhe të pakushtëzuar për qytetin e lindjes, Shkodrën (Kapinova, 2007).

Këto ndjesi, kujtime dhe përjetime emocionale, janë përmbledhur në vëllimin me poezi *“Brenjë dhe gaz nga Shkodra ime”* (2001), një titull që përçon dualitetin e ndjenjave ndaj një vendi që e ka formuar shpirtërisht dhe intelektualisht. Poezitë e këtij botimi janë të pasura me tone lirike dhe humoristike, duke përçuar nostalgji, ironi të hollë dhe dashuri të brendshme për jetën dhe njerëzit e Shkodrës.

Kritiku letrar dhe pedagogu Hasan Lekaj në parathënien e botimit e ka vlerësuar këtë krijimtari duke theksuar se *“fjala poetike e Simon Pepës është e lirë dhe njëkohësisht model papajtueshmërie midis përjetimit dhe jetës artistike në hapësirën e traditës poetike qytetare shkodrane.”* Kjo dëshmon për aftësinë e autorit për të ruajtur individualitetin estetik brenda një konteksti kulturor të pasur e të rrënjësor.

***Serenatë shkodrane* (Pepa, 2001)**

*Ja! Shkodra ra n'qetësi
E mbi oborre t'gjana
Si nuse plot stoli
Po na ndriçon hana
Kah udhëton ngadalë
Dritën e vet tue falë*

*Në rrugëzat plot gjelbërim
Heshtia ra qëkur
Tani po bëjnë pushim
Dhe lulevilet n'mur
Heshti dhe i fundit za
Në Shkodër që në gjumë ra...*

*Por vaj! Se këto tingëllime
I takojnë një kohe t'shkuar
Të shoh, o Shkodra ime
Të lodhur, të shkatërruar*

*U lëshua mbi ty mizori
Sa goja dot s'e thotë
E pat tërbuar zilia*

*Pse qe më e bukura n'botë
Por shpirti s'don t'ligështohet
Shpreson kjo zemra e ngrata
Se Shkodra prapë do t'zgjohej
Me kangë, me serenata*

Përfundime

Prof.dr. Simon Pepa është një nga studiuesit e rëndësishëm të zhvillimit të gjuhësisë shqiptare moderne. Puna e tij ka pasuruar fondin e njohurive të gjuhës shqipe, duke e ngritur atë në një nivel të ri kërkimor dhe shkencor. Kontributet e tij në fushën e leksikologjisë, fonetikës dhe dialektologjisë janë themelore për çdo studiues të gjuhës shqipe, pasi ai ka zbuluar dhe dokumentuar aspekte të gjuhës që shpesh ishin të panjohura ose të nënvlerësuara më parë. Vepra e tij ka mundësuar një kuptim më të thellë të zhvillimit të gjuhës shqipe dhe pasurimin e saj me elemente të rëndësishme nga trashëgimia kulturore dhe historike shqiptare.

Monografia e tij *“Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor”* është një shembull klasik i metodës së tij shkencore, që bazohet në mbledhjen e burimeve gojore dhe dokumentare për të krijuar një pasqyrë të gjerë dhe të detajuar të përdorimit të gjuhës shqipe në një kontekst të caktuar shoqëror dhe kulturor. Ky studim është një thesar për çdo studiues të gjuhësisë dhe kulturës shqiptare, duke ofruar një vlerësim të rëndësishëm për përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve të lidhura me jetën bujqësore dhe kulturore të shqiptarëve.

Një tjetër kontribut i rëndësishëm i prof. Pepës është studimi i tabuve dhe eufemizmave në gjuhën shqipe, një fushë që ka ndihmuar në pasurimin e kuptimit të përdorimit të gjuhës për të trajtuar tema të ndjeshme dhe të vështira shoqërore. Kjo punë ka zbuluar se si shqiptarët përdorin gjuhën për të menaxhuar normat dhe rregullat shoqërore dhe ka mundësuar një kuptim më të thellë të aspekteve kulturore dhe sociale të shoqërisë shqiptare.

Angazhimi ndërkombëtar i prof. Pepës ka qenë gjithashtu i rëndësishëm, duke promovuar gjuhën dhe kulturën shqiptare përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare. Kjo ka kontribuar në njohjen dhe vlerësimin e albanologjisë dhe ka ndihmuar në ndërtimin e një rrjeti ndërkombëtar për kërkime shkencore.

Në përfundim, mund të themi se prof.dr. Simon Pepa është një figurë e respektuar e gjuhësisë shqiptare dhe punën e tij shkencore mund ta shohim si një urë lidhëse mes të kaluarës dhe të ardhmes së gjuhës dhe kulturës shqiptare. Kontributi i tij ka qenë i pazëvendësueshëm për zhvillimin e studimeve gjuhësore dhe për pasurimin e trashëgimisë kulturore shqiptare. Puna e tij ka ndihmuar për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe dhe ai do të mbetet një figurë me rëndësi për studiuesit dhe pedagogët që merren me studimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Referencat

- [1]. Pepa, S. (1995). *Daniel Dajani S.J., Giovanni Fausti S.J. Dëshmitarë të një feje që nuk vdes*, Shkodër.
- [2]. Pepa, S. (2000). *Gjurmime kulturore*, Shkodër.
- [3]. Pepa, S., Osmani, T. (2000). *Tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe*, Shkodër.
- [4]. Pepa, S. (2001). *Brengë dhe gaz nga Shkodra ime*, Shkodër.
- [5]. Pepa, S. (2002). *Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor*, Shkodër.
- [6]. Pepa, S. (2003). *Zadrime dhe bijtë e ndritur të saj*, Shkodër.
- [7]. Pepa, S. (1995). “Justin Rrota – personalitet i kulturës dhe i letrave shqipe”, *Studime Shqiptare*. Nr.4. Shkodër.
- [8]. Pepa, S. (1995) “Veçori gjuhësore në veprën poetike të At Gjergj Fishtës”, Rilindja.
- [9]. Pepa, S. (1997). Pak fjalë për veprën "Leksiku historik i gjuhës shqipe", vëllimi I, të Prof. Kolë Ashtës, *No. 2 (1997): Phoenix* Pak fjalë për veprën "Leksiku historik I gjuhës shqipe", vëllimi I, të Prof. Kolë Ashtës | *Phoenix*
- [10]. Pepa, S. (2000). Tradita bujqësore ndër Shqiptarë si dëshmitare se ata janë një popull i lashtë dhe ndenjëtar në trojet e veta. *Phoenix*, 4(1-2), 63–68. <https://albanica.al/phoenix/article/view/877>

- [11]. Pepa, S. (2001). Atë Donat Kurti - dijetar i martirizuar, No. 1-3 (2001): Phoenix, Atë Donat Kurti - dijetar i martirizuar: Në 18-vjetorin e vdekjes | Phoenix
- [12]. Osmani, T. (2002). Vdiq Prof. Dr. Simon Pepa: Anëtar i kolegjiut të redaksisë së “Phoenix”. *Phoenix*, 6(1-3), 10–12. Vdiq Prof. Dr. Simon Pepa: Anëtar i kolegjiut të redaksisë së "Phoenix"
- [13]. Osmani, T. (2017). *Gjuhëtari Prof. Dr. Simon Pepa*, <https://www.shkodradaily.com/2017/02/simon-pepa.html>
- [14]. Kapinova, K. (2007). *Prof. Dr. Simon Pepa (1936 - 2002), albanolog i palodhur i letrave shqipe*. Fjala e Lirë. <https://www.shkoder.net/fjala/2007/kapinova.htm>